



Çështja e shirkut[1] është shumë e madhe, sikurse edhe rreziku i tij që është shumë i madh. Ai nxjerr njeriun nga Islami dhe largon atë nga lumturia. Prandaj, Allahu i Lartësuar ua tërhoqi vërejtjen robërve të Tij nga shirku në mënyrë të qartë, duke sqaruar se nuk e fal atë që bën shirk.

Ai thotë:

????? ?????? ??? ?????????? ??? ?????????? ????? ?????????????? ??? ??????
 ??????? ?????? ???????

S'ka dyshim se Allahu nuk fal t'i përshkruhet Atij shok, e përpos kësaj ia fal kujt të
 dojë.[2]

Po ashtu, Allahu, në disa ajete tjera, tregon se ia ka ndaluar xhenetin atij që i përshkruan Allahut shok dhe e ka kërcënuar atë me zjarr, duke thënë:

????????? ??? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ??????????
 ?????????????? ?????????????? ?????????? ?????? ?????????????????????? ?????? ??????????????

Vërtet, ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar atij xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.[\[3\]](#)

Ndërsa, Pejgamberi (sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem!) tregon se ai që vdes duke i përshkruar Allahut shokë në lutje hyn në zjarr. Ai thotë: *"Ai që vdes duke lutur dikë tjetër pos Allahut hyn në zjarr."*[\[4\]](#)

Madje, edhe i dashuri dhe miku i Allahut, Ibrahim (alejhis-selam!) kishte frikë për veten dhe bijtë e tij nga shirku. Andaj, kërkoi nga Allahu që ta ruajë atë dhe bijtë e tij nga shirku. Allahu i Lartësuar, duke rrëfyer për të thotë:

????????????? ?????????? ??? ?????????? ??????????????

...dhe më mbroj mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve.[\[5\]](#)

Llojet e shirkut

Shirku ndahet në dy lloje: në shirk të madh dhe në shirk të vogël.

Shirkui madh është përshkrimi dikujt tjetër pos Allahut diçka që është e veçantë për Të, siç është therja e kurbanit, rënia në sexhde, dua (lutja), etj.

Kurse, shirku i vogël është ai që në Kur'an dhe sunnet është quajtur shirk, por nuk e ka arritur shkallën e shirkut të madh, sikurse thënia "çfarë do Allahu dhe ti", syfaqësia e pakët, betimi në dikë tjetër pos Allahut, etj.

Dallimi ndërmjet shirkut të madh dhe atij të vogël

1. Shirku i madh rrënon të gjitha veprat, kurse shirku i vogël rrënon vetëm veprat që i shoqëron ai.

2. Shirku i madh shkakton që bërësi i tij të mbetet përherë në zjarr, ndërsa shirku i vogël nuk obligon një gjë të tillë.

3. Shirku i madh e nxjerr bërësin e tij nga feja, ndërsa i vogli jo.

Por, Sido që të jetë, muslimani duhet të largohet nga shirku, qoftë i madh apo i vogël dhe të ruhet prej tij në përgjithësi.

O Allahu im, kërkoj mbrojtje tek Ti nga shirku që e di dhe kërkoj falje për mëkatin që nuk e di.

-

Pyetje

1. Cili është dallimi ndërmjet shirkut të madh dhe atij të vogël?
2. Sill një shembull për shirkun e vogël!
3. Çfarë dispozite ka të rënit në sexhde dikujt tjetër pos Allahut?
4. Cili është dënimi për atë që bën shirk Ditën e Gjykimit?
5. Sill argument për këtë që thua!
6. Pse Allahu ua tërhoqi vërejtjen robërve të Tij nga shirku?
7. A e nxjerr shirku i vogël njeriun nga Islami?

Përktheu: Jusuf Kastrati

Marrë nga libri: "Et-Teuhid" - Instituti i Mësimit të Gjuhës Arabe - Universiteti "Imam" në Riad.

[\[1\]](#)

Shirk domethënë: T'i shoqërosh Allahut dikë në adhurim. Sh.p.

[\[2\]](#) Suretu en-Nisa: 48

[\[3\]](#) Suretu el-Maideh: 72

[\[4\]](#) Hadithin e transmeton Buhariu

[\[5\]](#) Suretu Ibrahim: 35